



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2942/1 prot.

Himarë, më 23.04 . 2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Himarë.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftojmë se ditën e martë më datë 28.04.2026, ora 10:30 në sallën “Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja për muajin prill të Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë këtë rend dite.

Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin dhe vënien në dispozicion për zhvillim në kuadër të nënprojekteve “Qendra e shërbimeve publike Palasë dhe copëzat” të pasurisë së llojit kullotë, me nr. 29/84 me sipërfaqe totale 54391 m² (kullotë), në zonën kadastrale 2863, Himarë, në pronësi të Bashkisë Himarë, në favor të MEI, duke ruajtur të pa ndryshuar pronësinë mbi pasurinë dhe pa kryer transferim”;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e planit të punës, për miratimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për restaurimin e banesave shumë të amortizuara për familjet në nevojë të programit të strehimit social për vitin 2026”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimit e mbetjeve të ngurta, në zonën e Palasës”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për krijimin e shoqërisë bashkiake “Himara Invest” SH.P.K., në pronësi 100% të Bashkisë Himarë”.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për propozimin për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-31 mars 2026, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike” ;
7. Të ndryshme.



Sekretari

Zaho Dedi